



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE
DREJTORIA E ZVOGËLIMIT TË RISKUT DHE FATKEQËSIVE DHE E
PARANDALIMIT

Nr. 18/11 Prot

Tiranë, më 5.1 2022

LËNDA: Analiza vjetore mbi realizimin e detyrave gjatë vitit 2021.

Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit, bazuar në prioritetet dhe objektivat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile që në fillim të vitit 2021, ka përcaktuar prioritetet dhe objektivat e saj.

Objektivat e Drejtorisë së Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe të Parandalimit për vitin 2021 kanë qenë:

1. Të realizohen procedurat për fillimin e punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.
2. Të realizohen procedurat për fillimin e punës për hartimin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel Qendror.
3. Të realizohen procedurat për fillimin e punës për hartimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.
4. Bashkërendimi i punës për realizimin e veprimtarisë ndërinstitucionale të grupeve të punës në procesin e hartimit të dokumenteve, si Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel Qendror dhe Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.

Mbi realizimin e Detyrave të Planifikuara për vitin 2021:

Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit në përbërjen e saj ka tre sektorë:

1. Sektori i Programeve dhe Strategjive;
2. Sektori i Koordinimit Ndërinstitucional dhe Zvogëlimit të Risqeve dhe Fatkeqësive;
3. Sektori i Planifikimit të Mbrojtjes Civile.

Gjatë vitit 2021, Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit është angazhuar maksimalisht në përmbushje të detyrave të saj me qëllim realizimin e objektivave të parashikuara.

Për këtë qëllim është punuar me plane mujore, të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i AKMC-së.

I. Në fushën e legjislacionit:

Gjatë vitit 2021, Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit ka dhënë kontribut në përgatitjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, duke pasur persona të përfshirë në grupin e punës të ngritur nga Drejtori i Përgjithshëm i AKMC-së, si dhe për hartimin e akteve ligjore të ministrive të linjës.

Konkretisht, përfaqësues nga Sektori i Programeve dhe Strategjive kanë kontribuar në hartimin e 8 akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, konkretisht në projektvendimet si më poshtë:

1. Procedurat dhe afatet e pajisjes me vërtetim mbi riskun.
2. Për miratimin e masës së kompensimit të dëmeve, procedurave, afateve, strukturave shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve.
3. Për miratimin e flamurit, stemës dhe uniformës së AKMC.
4. Për miratimin e kriterëve për trajtimin e vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile.
5. Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.
6. Për miratimin e ngritjes dhe funksionimit të sistemit të numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112.
7. Për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive.
8. Për miratimin e kriterëve për identifikimin e subjekteve private, strukturave përgjegjëse për identifikimin e tyre, si dhe rregullave për realizimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre.

Gjithashtu, nga ky sektor është dhënë mendim për disa akte ligjore dhe dokumente të hartuara nga ministrinë e linjës, si më poshtë vijon:

- ✓ Dhënie mendimi për projektvendimin “Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi zonat e përcaktuara për akuakulturë (zpa) në Shqipëri”.
- ✓ Shqyrtim i planit të Veprimt për direktivat e nënsektorit të Ujit dhe dhënie mendimi.
- ✓ Shqyrtim i udhëzuesit “Flood Hazard and Risk Mapping for the Drin/Drin – Bune / Bojana River Basin – Guidebook”.
- ✓ Mbi vendimin e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha në lidhje me Rregulloren e shfrytëzimit të digave Ulëz, Shkopet dhe Bistricë.

- ✓ Shqyrtimi dhe dhënie mendimi në lidhje me Draft Planin e Punës së grupit dhe Draft Rregulloren e punës së grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore.
- ✓ Dhënie mendimi për Draft ligjin “Për burimet ujore”.
- ✓ Shqyrtim dhe dhënie mendimi për projektvendimin “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 230, datë 17.4.2019, “Për shpalljen, kategorizimin dhe emërtimin e portit të llojit MBM në Porto Romano, Durrës “Port i hapur për trafik ndërkombëtar”.
- ✓ Dhënie kontributi për projektvendimin “Për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura”, të përgatitur nga Ministria e Kulturës.

II. Në fushën e programeve apo dokumenteve të ndryshëm strategjikë:

Drejtorja e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe Parandalimit, përkatësisht Sektori i Programeve dhe Strategjive gjatë vitit 2021 ka përgatitur informacionin e kërkuar mujor, 3-mujor, 6-mujor dhe sipas rastit në lidhje me zbatimin e detyrimeve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për sa i takon:

1. Direktivës së Mbrojtjes;
2. Strategjisë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë;
3. Mbi zbatimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare;
4. Mbi zbatimin e Strategjisë së Luftës kundër Terrorizmit;
5. Është marrë pjesë në takimin informues për Strategjinë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë, si dhe në stërvitjen testuese TTX (Table Top Exercise) të zhvilluar nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Qëndren “RACVIAC”, të realizuar në nivel kombëtar për vlerësimin e kësaj strategjie.

Për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë:

Sektori i Programeve dhe Strategjive ka pasur si prioritet angazhimin e tij për të kontribuar në procesin e hartimit të dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.

Në këtë kuadër, puna përgatitore ka filluar që në tremujorin e parë të vitit 2021.

Nga ana e këtij sektori është përgatitur projekturdhri “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik të Punës për përgatitjen e projektit të Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë”.

Janë shqyrtuar dhe është dhënë mendim lidhur me dokumentet e përgatitura dhe të dërguara nga PNUD-i “Zhvillimi i Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit dhe Menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Shqipëri” dhe dokumentit “Drejt Strategjisë Gjithëpërfshirëse të Menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Shqipëri”.

Pas miratimit të urdhërit nr. 57, datë 29.06.2021 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik të Punës për përgatitjen e projektit të Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë”, nga ana e Sektorit të Programeve dhe Strategjive ka vijuar puna për të përgatitur materiale dhe dokumente të ndryshme, për të siguruar fillimin e veprimtarisë së Grupit Ndërinstitucional të punës dhe Grupit teknik të punës për hartimin e projektit të Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë, si më poshtë vijon:

- Studim i Kuadrit Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015-2030.
- Studim i Direktivave, vendimeve dhe rregulloreve të Bashkimit Evropian në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile.
- Studim i dokumenteve të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe UNDRR-së (United Nations Office for Disaster Risk Reduction) për hartimin e strategjisë së zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.
- Studim i Planit të Veprimit të Komisionit Evropian mbi implementimin e Kuadrit Sendai, si dhe Planit të Veprimit të OKB-së për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive për Aftësinë Ripërtëritëse.
- Detyrimet ndërsektoriale që burojnë nga Axhenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, Marrëveshja e Parisit mbi ndryshimin e klimës, si dhe Axhenda e Re Urbane.
- Analizim i të gjithë dokumenteve të ndryshme strategjike të miratuara më parë si strategji, plane, programe që përfshijnë Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, siç janë:
 - Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim,
 - Strategjia e Sigurisë Kombëtare,
 - Dokumenti Strategjik i Ujitjes, Kullimit dhe Mbrojtjes nga Përmbytjet,
 - Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore,
 - Strategjia e Mjedisit.
- Analizim i dokumenteve të ndryshme studimore dhe i të dhënave që kanë institucionet që ato përfaqësojnë, të cilat i shërbejnë hartimit të SKZRF.

Është përgatitur Urdhri nr. 96, datë 08.07.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC “Për ngritjen dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik të Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për hartimin e projektit të Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë” dhe është ndjekur zbatimi i tij.

Është zhvilluar takimi i parë i Grupit Ndërinstitucional të Punës në datë 27.10.2021 ku janë bërë njoftimet për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Grupit Ndërinstitucional të Punës, si dhe janë përgatitur prezantimet dhe materialet përkatëse për në takim.

Në rolin e Sekretariatit Teknik nga ana e Sektorit të Programeve dhe Strategjive janë përgatitur minutat e takimit të grupit të Punës dhe së bashku me materiale të tjera, si prezantime, metodologji për hartimin e Strategjisë, u janë dërguar anëtarve të Grupit Ndërinstitucional të Punës.

Nga ana e Sektorit të Programeve dhe Strategjive, vazhdon puna për përgatitjen e materialeve për zhvillimin e takimit të grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për hartimin e Strategjisë, si dhe

për bashkërendimin e veprimtarisë ndërsintitucionale të punës për hartimin e projektit të Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë.

Për hartimin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel Qendror:

Spektori i Koordinimit Ndërinstitucional dhe Zvogëlimit të Risqeve dhe Fatkeqësive ka pasur si prioritet angazhimin e tij për të kontribuar në procesin e hartimit të dokumentit të Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel Qendror. Për këtë qëllim, puna ka nisur që në muajin mars 2021.

Nga punonjësit e sektorit janë studiuar dhe analizuar dokumente të ndryshme në lidhje me Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë, si:

- Dokumenti i Metodologjisë së Turqisë për zhvillimin e Vlerësimit të Riskut;
- Dokumenti i Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë në Shqipëri;
- Material nga MDPI për Përparimin e shkencës së hapur për më shumë se 25 vjet, që nga viti 1967;
- Dokumente të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe UNDRR-së (United Nations Office for Disaster Risk Reduction) për hartimin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror;
- Dokumente të ndryshme të vlerësimit të risqeve.

Është dhënë kontribut në përgatitjen e projekturdhrit të Kryeministrit “Për ngritjen dhe funksionimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës për kryerjen e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel Qendror”.

Është përgatitur Urdhri nr. 98, datë 08.07.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC “Për ngritjen dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë në nivel Qendror” dhe është ndjekur zbatimi i tij.

Janë evidentuar përfaqësuesit e ministrive dhe të institucioneve të tjera në Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë në nivel Qendror.

Është bërë organizimi i grupeve ndërinstitucionale të punës dhe ka nisur veprimtaria e tyre duke bashkërenduar punën për Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror.

Bazuar në Metodologjinë e Turqisë, është përshtatur Metodologjia për Zhvillimin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror.

Në datën 27.10.2021, u mbajt takimi i parë i Grupit Ndërinstitucional të Punës për Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror.

Gjatë muajve Nëntor-Dhjetor 2021 janë organizuar dhe zhvilluar 7 takime me nëngrupet teknike ndërinstitucionale, si dhe janë parashikuar edhe 27 takime të tjera deri me datë 31 mars 2022.

Janë përgatitur materiale që do t’u vihen në dispozicion Nëngrupeve të Punës mbi Vlerësimin e Riskut prej tërmeteve, përmytjeve nga lumenjtë, përrrenjtë dhe çarjet e digave, rrëshqitjeve të tokës, rënies së shkëmbinjve dhe lëvizjeve të tjera masive, doborës së rëndë dhe ortekëve, zjarreve në pyje, sëmundjeve infektive dhe prej rrezikut teknologjik.

Për hartimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile:

Sektori i Planifikimit të Mbrojtjes Civile ka pasur si prioritet angazhimin e tij për të kontribuar në procesin e hartimit të dokumentit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile. Për këtë qëllim, puna ka nisur që në fillim të vitit 2021. Nga punonjësit e sektorit janë studiuar dhe analizuar dokumente të ndryshme vendase dhe të huaja në lidhje me Hartimin e Projektit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile. Këtu mund të përmendim:

1. Plani Kombëtar ekzistues i Emergjencave Civile.
2. Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë në Shqipëri.
3. Kuadri Sendai “Për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive 2015-2030”.
4. Marrëveshja e Parisit për ndryshimet klimatike.
5. Udhëzimi për parandalimin e fatkeqësive. (DG ECHO (Directorate General for Humanitarian Aid and Civil Protection e BE).
6. Programi i Trajnimit për Gatishmërinë ndaj Fatkeqësive. (Përgatitur nga Federata Ndërkombëtare e Kryqit Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe).
7. Struktura, Roli dhe Mandati i Mbrojtjes Civile në Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive për Evropën Juglindore”. (Përgatitur nga: Banka Botërore, MC Italiane, OKB, BE, MC e Rep.Sllovene).
8. Plane të Emergjencave Civile të vendeve të ndryshme.

Është analizuar në tërësi Plani Kombëtar ekzistues i Emergjencave Civile, ku janë përgatitur përditësimet në lidhje me bazën e re ligjore dhe strukturat e mbrojtjes civile. Është përgatitur një strukturë e re e PKEC, më e thjeshtë për t’u përdorur nga të gjithë aktorët, e cila do të diskutohet me grupet ndërinstitucionale të punës për hartimin e Projektit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.

Është dhënë kontribut në përgatitjen e projekturdhrit të Kryeministrit për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për Hartimin e Projektit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.

Është përgatitur Urdhri nr. 97, datë 08.07.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC “Për ngritjen dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik të Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për hartimin e Projektit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile” dhe është ndjekur zbatimi i tij.

Janë evidentuar përfaqësuesit e ministrive dhe të institucioneve të tjera në Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Hartimin e Projektit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.

Është hartuar metodologjia për përgatitjen e projektit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.

Është bërë organizimi i grupeve ndërinstitucionale të punës dhe ka nisur veprimtaria e tyre duke bashkërenduar punën për Hartimin e Projektit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.

Është përgatitur axhenda e takimit dhe një informacion i shkurtër për pjesëmarrësit lidhur me qëllimin dhe objektivat e tre dokumenteve që do të hartohen, si dhe të dokumenteve kryesorë që

janë bazë për hartimin e tyre si, Kuadri Sendai, Marrëveshja e Parisit për ndryshimet klimatike, udhëzuesi i DG ECHO për përgatitjen.

Është përgatitur projekturdhri dhe është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile: Urdhri nr.162, datë 25.10.2021, "Për organizimin dhe zhvillimin e takimit të grupeve ndërinstitucionale të punës, më datë 27.10.2021".

Në datën 27.10.2021, u zhvillua takimi i parë i Grupit Ndërinstitucional të Punës për Hartimin e Projektit të Planit kombëtar për Emergjencat Civile.

III. Pjesëmarrje në grupe pune ndërinstitucionale:

Përfaqësues nga Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit kanë qënë pjesëmarrës në grupe pune të ndryshme ndërinstitucionale.

Konkretisht, përfaqësues nga Sektori i Programeve dhe Strategjive kanë marrë pjesë në disa grupe pune ndërinstitucionale si më poshtë:

1. *Pjesëmarrje dhe kontribut në grupin e punës për përgatitjen e hartave të rrezikut dhe riskut në basenin e Drinit, në kuadër të projektit "Adaption to Climate Change through Flood Risk Management, Western Balkans" nga GIZ.*

Në kuadër të këtij grupi ndërinstitucional pune është marrë pjesë në disa takime të zhvilluara gjatë këtij viti, ku është diskutuar dhe kontribuar me komente dhe sugjerime në lidhje me hartat e riskut dhe hartat e rrezikut, metodologjinë e përdorur, aspektet gjinore në menaxhimin e riskut nga përmbytjet, planin e menaxhimit të riskut të përmbytjeve për Shkodrën, aspekte të tjera, mbi hapat në të ardhmen, etj.

Gjithashtu, është marrë pjesë dhe kontribuar në takimin e zhvilluar në kuadër të projektit "Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet menaxhimit ndërkufitar të riskut nga përmbytjet në Ballkanin Përendimor", i cili ka si qëllim krijimin e hartave fizike për menaxhimin e riskut nga përmbytjet në zonat ndërkufitare pilote të lumit Drin, Bunë dhe liqenit të Shkodrës.

2. *Pjesëmarrje dhe kontribut në Grupin Ndërinstitucional të Punës, për hartimin e paketës ligjore "Për menaxhimin e burimeve ujore".*

Grupi Ndërinstitucional i Punës, i ngritur nëpërmjet Urdhërit të Kryeministrit Nr. 24 datë 9.2.2021 për hartimin e paketës ligjore "Për menaxhimin e burimeve ujore", gjatë vitit 2021 ka zhvilluar disa takime. Është marrë pjesë në mënyrë të vazhdueshme në këto takime dhe është kontribuar në hartimin e kësaj pakete duke dhënë mendime, sugjerime, komente sipas rastit, të cilat në disa raste janë përcjellë dhe në formë elektronike.

Komentet dhe sugjerimet kanë qënë për sa i përket:

- Objektit dhe fushës së zbatimit të draftligjit;
- Disa dispozitave të caktuara të draftligjit të cilat referojnë tek aktet nënligjore;
- Termave të përdorur në këtë draft ligj, etj.

3. Pjesëmarrje dhe kontribut në grupin Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian, për Kapitullin 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimaterike”.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe të Projekteve është hartuar projekturdhëri për miratimin përfaqësuesve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), si anëtarë në Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian, për Kapitullin 30 “Marrëdhëniet me Jashtë” dhe Kapitullin 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimaterike”.

- Është kryer plotësimi i pyetësorit të vlerësimit të nevojave për trajnim të GNPIE –ve për kapitullin 27 “Mjedisi” dhe kapitullin 30 “Marrëdhëniet me jashtë”;
- Janë dhënë mendime në lidhje me Udhëzuesin për përgatitjet për procesin screening të Kapitullit 27 “Mjedisi” dhe të Kapitullit 30 “Marrëdhëniet me Jashtë”;
- Janë bërë përditësimet për GNP për Kapitullin 27 "Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike" dhe Kapitullin 30 “Marrëdhëniet me Jashtë”;
- Janë shqyrtuar dhe analizuar dokumentet e Analizës më të fundit të Mangësive Ligjore dhe Analizës së Mangësive Institucionale e Administrative të përditësuar nga anëtarët e GNPIE së Kapitullit 30 “Marrëdhëniet me Jashtë” dhe Kapitullit 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”;
- Eshtë bërë reflektim i komenteve të ardhura nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në Progres-Raportin për Kapitullin 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”;
- Është kryer plotësimi i pyetësorit të Konsultimit të Përgjigjes Strategjike Kombëtare për IPA III;
- Është realizuar dhënia e komenteve në lidhje me WINDOW 3 – IPA III Sectorial - Strategic Response One Environment and Climate Change, për pjesën “Mbrojtja Civile”.
- Është marrë pjesë në takimet e zhvilluara për kapitullin 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike” dhe është kontribuar në përgatitjen e informacioneve përkatëse për pjesën që i përket mbrojtjes civile, për kapitullin 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”.
- Është marrë pjesë në takimin online NDC Assist II - Forcimi i financimit dhe zbatimit të Kontributeve Kombëtare të Synuara.
- Është dhënë kontribut në përgatitjen e materialit të AKMC-së në kuadrin e zhvillimit të takimit të 12-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian, Shqipëri “Transporti, energjia, mjedisi dhe zhvillimi rajonal”.

4. Pjesëmarrje dhe kontribut në kuadër të Task Forcës së Përbashkët për Programin e Bashkëpunimit ndërkufitar IPA III CBC 2021-2027.

Spektori i Programeve dhe Strategjive, nëpërmjet përfaqësuesit të tij në këtë Task-Forcë, në bashkëpunim me përfaqësuesin e Ministrisë së Mbrojtjes, anëtar i Task-Forcës ka kontribuar për sa i takon çështjeve të mbrojtjes civile, duke marrë pjesë në takimet e zhvilluara, si dhe duke bërë sugjerime dhe komente në materialet e përgatitura në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar 2021-2027.

Në këtë kuadër është bërë shqyrtimi i Dokumentit të Programit të IPA CBC Programi Shqipëri - Kosovë 2021-2027, i Dokumentit të Programit të IPA CBC Programi Shqipëri-Mali i Zi 2021-

2027, i Dokumentit të Programit të IPA CBC Programi Shqipëri-Maqedoni e Veriut 2021-2027 dhe i Dokumentit të Programit të IPA CBC Programi Shqipëri – Greqi 2021-2027.

Programi 2021-2027 IPA III CBC midis Malit të Zi dhe Shqipërisë, Shqipërisë dhe Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Greqisë, është rezultat i punës së përbashkët programuese, të kryer nga strukturat operative të vendeve pjesëmarrëse në koordinim me përfaqësuesit e institucioneve përkatëse qendrore, institucioneve lokale të zonës së programit dhe organizatave lokale. Kontributi ynë ka qënë si anëtar të Task-Forcës së përbashkët midis këtyre vendeve për të përgatitur këtë dokument programi. E rëndësishme është se në këto programe krahas prioriteteve të tjera, prioritet mbetet dhe “Mbrotjtja e mjedisit, adaptimi dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i risqeve”.

Gjithashtu, një përfaqësues nga Sektori i Koordinimit Ndërinstitucional dhe Zvogëlimit të Risqeve dhe Fatkeqësive ka marrë pjesë në disa grupe ndërinstitucionale si më poshtë:

- ✓ Pjesëmarrje në grupin ndërinstitucional të punës për përgatitjen e planeve të menaxhimit të Baseneve Ujore Mat, Ishëm dhe Erzen.
- ✓ Pjesëmarrje në grupin ndërinstitucional të punës për hartimin e projektplanit të menaxhimit të rrezikut nga përmytjet për zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmytjet ose ka gjasa të ndodhin përmytje, Drin, Bunë, 4, 5 dhe 6, të shpallura me vendimin nr.1, datë 15.06.2021, të Këshillit Kombëtar të Ujit (Territori i Njësive Administrative Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethinat dhe Velipojë të Bashkisë Shkodër dhe Njësive Administrative Bushat të Bashkisë Vau i Dejës).

5. Pjesëmarrje në aktivitete të tjera:

Përfaqësues të Drejtorisë së Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe të Parandalimit kanë marrë pjesë edhe në disa aktivitete të tjera, ku mund të përmendim:

- Pjesëmarrje në takimin e grupit të punës së ekspertëve të posaçëm të riskut sizmik të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BSEC), organizuar online në datë 09.06.2021. Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi i mendimeve, eksperiencave, dhe praktikave më të mira midis Shteteve Anëtare, atyre vëzhguese dhe partnerëve të dialogut sektorial mbi riskun sizmik. Me prezantimin e Raportit të Vlerësimit nga grupi i punës i posaçëm për riskun sizmik dhe të Planit të Veprimit mbi riskun sizmik, synohet të inkurajohet diskutim dhe përfaqësuesit të kontribuojnë me komente dhe rekomandime mbi forcimin e bashkëpunimit reciprok në fushën e riskut sizmik.
- Pjesëmarrje në takimin për Bashkëpunimin në Ndihmën Emergjente, të Organizatës “Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi” (BSEC). Qëllimi i takimit ishte marrja parasysh e kërkesës së pjesëmarrësve për të pasur qasje në Databazën e Unifikuar të BSEC, përcaktimi i Koordinatorit të Grupit të Punës për BNE, të BSEC për periudhën 1 Korrik 2021 – 30 Qershor 2023, ku u vendos që këtë mandat do ta ketë Republika e Turqisë, si dhe vendosja e dy Grupeve të Punës Ad Hoc për “Përmytjet dhe gërryerjet nga përrenjtë”, si dhe për

“Zjarret masive të pyjeve”, të cilat do të jenë pjesë e Grupit të Punës për Ndihmën e Emergjente.

- Pjesëmarrje në aktivitetin me temë “Drejt një Sigurie Rrugore të Qëndrueshme”. Në këtë aktivitet janë trajtuar çështjet e edukimit për sigurinë rrugore, forcimi i ndërgjegjësimit dhe ndikimit në masat për shumëfishimin e efekteve të përmirësimit të sigurisë rrugore në Shqipëri. Gjithashtu, janë adresuar zgjidhje të ndryshme teknike duke e vënë theksin më shumë në qëndrueshmërinë nga ana mjedisore dhe potencialin e zgjidhjeve të IT-së në mbështetjen e menaxhimit të sigurisë rrugore.
- Pjesëmarrje në takimin e zhvilluar në kuadër të projektit të “IPA Floods and Fires”, me tematikë “Mbështetja e BE-së për parandalimin e përmytjeve dhe menaxhimin e riskut nga zjarret në pyje në Ballkanin Përendimor dhe Turqi” - IPA Përmytjet dhe Zjarret. Objektivi i këtij takimi ishte përmirësimi i kapaciteteve të përfituesve për të zhvilluar Planin e Menaxhimit të riskut nga përmytjet, si dhe për të forcuar Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm nga përmytjet, si dhe për rritjen e kapaciteteve, për zhvillimin e metodologjive të harmonizuara në nivel rajonal, për vlerësimin e riskut nga zjarret në pyje, si dhe për zhvillimin dhe përditësimin e vlerësimeve të riskut dhe planeve të menaxhimit të riskut për zjarret në pyje duke përfshirë komponentin ndërkuftar dhe përmirësimin e kapaciteteve rajonale për gadishmërinë dhe përgjigjen ndaj zjarreve në pyje.

6. Të ndryshme:

- Kryerja e detyrave të Sekretariatit Teknik të Komitetit të Mbrojtjes Civile, të ngritur me Urdhër Nr. 2, datë 06.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC “Për ngritjen e Sekretariatit Teknik të Komitetit të Mbrojtjes Civile”, ndryshuar me Urdhër Nr. 2/1, datë 06.01.2021.

Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit, me një përfaqësues të saj, ka qenë pjesë e Sekretariatit Teknik të Komitetit të Mbrojtjes Civile.

Është realizuar organizimi i mbledhjeve të Komitetit të Mbrojtjes Civile (KMC), përgatitja e materialeve dhe shpërndarja e tyre të gjithë anëtarëve të komitetit, lajmërimi për datën dhe orën e mbledhjes, janë zbardhur minutat e takimit dhe vendimet e KMC-së.

Në këto mbledhje është diskutuar në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve sipas situatave të ndryshme të emergjencave civile, duke marrë vendimet e nevojshme dhe dhënë udhëzimet për menaxhimin e situatës.

Ndër takimet më të rëndësishme të KMC-së, përmendim:

Mbledhja e realizuar në datën 07.04.2021 me kërkesën e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Znj. Belinda Balluku, për të diskutuar në lidhje me problemin e krijuar në Aeroportin

Ndërkombëtar "Nënë Tereza" të Rinasit, ku një grup punonjësish të kullës së vrojtimit pezulluan punën në këtë aeroport. KMC mori Vendimin Nr.1, datë 07.04.2021 "Për normalizimin e situatës dhe funksionimin normal të Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit". Një ndër pikat e këtij vendimi ishte që, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrë masat e nevojshme për të bërë operacionin kontrollin e trafikut ajror, qoftë edhe duke zëvendësuar, nëse lind nevoja, kontrollorët e larguar me kontrollorë të rinj vendas ose të huaj.

Mbledhja e realizuar në datën 02.08.2021, në të cilën është marrë Vendimi Nr.2, datë 02.08.2021 "Për normalizimin e situatës së shkaktuar nga zjarret në gadishullin e Karaburunit", ku u vendos që Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile të marrë të gjitha masat për ndërhyrje nga ajri, me qëllim shuarjen e zjarreve dhe normalizimin e situatës.

- Kryerja e detyrave të Sekretarisë Teknike të Komisionit Teknik Këshillimor, të ngritur me Urdhër Nr. 9, datë 15.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC "Për ngritjen e Sekretarisë Teknike të Komisionit Teknik Këshillimor".

Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit, me anë të një përfaqësuesi të saj, ka qenë pjesë e Sekretarisë Teknike të Komisionit Teknik Këshillimor për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive.

Është realizuar organizimi i mbledhjeve të Komisionit Teknik Këshillimor, përgatitja e materialeve dhe shpërndarja të të gjithë anëtarët e Komisionit, lajmërimi për datën dhe orën e mbledhjes, janë zbardhur minutat e takimit, etj.

- **Angazhimi në grupe pune brenda institucionit.**

- Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit, me anë të një përfaqësuesi të saj ka qenë pjesë e Komisionit të dorëzimit të mallit, të ngritur me Urdhër Nr. 30, datë 18.02.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC, për "Ushqim i koncentruar për bagëtitë", në Bashkinë Shkodër.
- Ka qenë pjesë e Komisionit "Për pritjen e mallit", të ngritur me Urdhër Nr. 95, datë 07.07.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC, për "Furnizim me lëndë djegëse për automjetet (Diesel-Gazoil)" për AKMC.
- Punonjësit e Drejtorisë kanë qenë pjesë e grupeve të ndryshme të punës siç është identifikimi, verifikimi dhe marrja në dorëzim e banesave të dëmtuara nga tërmeti i datës 1 qershor 2019, të cilat u rindërtuan nga Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (ish-Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile) sipas urdhërit nr. 89, datë 21/06/2021 "Për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të banesave të rindërtuara nga Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (Ish-Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile) të cilat u dëmtuan nga tërmeti i datës 1 qershor 2019, në bashkitë Korçë, Devoll dhe Kolonjë".
- Në bazë të urdhërit nr.105 datë 26.07.2021 "Për angazhimin dhe pjesëmarrjen në testimin final të stacioneve meteorologjike të rehabilituara në kuadër të implementimit të programit

punës”, punonjësit e Drejtorisë kanë qenë të angazhuar dhe kanë vazhduar punën për kontrollin dhe mbarëvajtjen e procesit.

- Gjithashtu, si pjesë e grupit përkatës të punës në bazë të urdhërit nr.151 datë 18.10.2021 “Për angazhimin dhe pjesëmarrjen në testimin final të stacioneve hidrologjike të rehabilituara në kuadër të implementimit të programit të punës”, janë kryer takime dhe shkëmbime korrespondece (e-mail, telefon) me palët e interesuara. Është mbajtur takim me përfaqësues të Kompanisë TCN, e cila ka fituar tenderin për mirmbajtjen e stacioneve hidro-metereologjike. Si pjesë e grupit përkatës të punës, në bazë të urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 168, datë 01.11.2021, një specialist nga Drejtoria ka marrë pjesë në testimin e kryer në stacionet hidrologjike, pjesë e Programit “PRONEWS. Për këtë testim u ngrit një grup pune i përbërë nga dy specialistë të caktuar nga fondacioni “CIMA”, një përfaqësues nga AKMC, një nga IGJEUM, si dhe një përfaqësues i kompanisë TCN.

IV. Përpunimi dhe trajtimi i korrespondencës zyrtare:

Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit ka dërguar shkresa për problematika të ndryshme në adresë të shumë institucioneve qendrore dhe vendore, ka shqyrtuar, përpunuar dhe dhënë përgjigje të specializuar dhe brenda afateve - shkresave të ardhura. Korrespondenca zyrtare ka qenë me e-mail dhe në formë shkresore.

Rreth 300 korrespondenca shkresore janë shqyrtuar dhe trajtuar nga kjo Drejtori, pa përfshirë korrespondencën e shqyrtuar dhe trajtuar me e-mail.

Me qëllim njohjen me procedurat për zbatimin e detyrimeve ligjore, i kemi dërguar shkresa të gjithë prefektëve të qarqeve me lëndë “Për njohjen dhe zbatimin e detyrimeve ligjore dhe njoftim mbi fillimin e funksionimit të Komitetit të Mbrojtjes Civile”.

Me qëllim parandalimin e zjarreve dhe përgatitjen për t’i përballuar ato, në fillim të muajit prill 2021, u është dërguar një shkresë të gjithë prefektëve të qarqeve për marrjen e masave për përballimin e emergjencave verore, si dhe informim.

Janë përgatitur dhe dërguar shkresa bashkive, në lidhje me detyrimin ligjor të përcaktuar në VKM Nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, për dërgimin pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, të raportit 8-mujor për përdorimin nga ana e tyre të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit, të planifikuar për mbrojtjen civile.

Është përgatitur dhe dërguar shkresë Ministrit të Financave nëpërmjet Kryetarit të Komitetit të Mbrojtjes Civile, në lidhje me akordimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për bashkitë, në vlerën 4% të buxhetit vjetor të tyre.

Është përgatitur dhe i është dërguar shkresë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, ku është kërkuar ndërhyrja e tij pranë Ministrit të Financave, në lidhje me fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për bashkitë, për të mundësuar akordimin e këtij fondi në vlerën 4% të buxhetit vjetor të tyre.

Janë përgatitur dhe dërguar shkresa të gjitha ministrive të linjës, në lidhje me krijimin pranë tyre të strukturës për mbrojtjen civile, sipas detyrimit ligjor të përcaktuar në VKM Nr. 431, datë

15.07.2021 "Për përbërjen dhe detyrat e Njësive Organizative që kanë në kompetencë të tyre çështjet e Mbrojtjes Civile në ministritë e linjës".

Janë hedhur në database të dhëna nga 125 studime gjeologo- inxhinierike të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Qëllimi i ruajtjes së këtyre të dhënave është evidentimi i zonave me risk më të lartë rrëshqitjeje.

Nga 125 studimet e kryera nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar rezulton:

- ✓ 77 prej tyre janë studime të zonave ku përfshihen banesa të rrezikuara (maksimumi deri në 5 banesa) të cilat ndodhen jashtë trupit të rrëshqitjes dhe kanë pësuar dëmtime të lehta në mure, në dysheme, oborr, murr rrethues apo tokë bujqësore. Studimet e kryera janë kryesisht në bashkitë Tiranë, Klos, Kukës, Gramash, Has dhe Librazhd.
- ✓ 33 prej tyre janë studime të zonave ku përfshihen banesa që ndodhen në trupin e rrëshqitjes, të dëmtuara rëndë dhe rrezikohet jeta e banorëve, kryesisht në bashkitë Tiranë, Klos, Mirëditë etj.
- ✓ 15 studime janë në zona me më shumë se 5 banesa-ose për objekte të tjera, në bashkitë Tropojë, Tiranë, Vlorë, Skrapar, Berat dhe Koçovë. Për shkak të rrëshqitjeve të tokës, rënies së shkëmbinjve apo rrëzimit të gurëve, rrezikohet dëmtimi i objekteve dhe ndërprerja e jetës së përditshme.

Për banesat jashtë trupit të rrëshqitjes dhe objektet e tjera rekomandohet të kryhet disiplinimi i ujërave sipërfaqësore dhe atyre të përdorimit të përditshëm, ndërtimi i mureve mbajtëse, të mos kryhen ndërtime të reja në zonë pa kryer më parë studime gjeologo-inxhinierike, të largohet nga shpati pjesa e rrëshqitur dhe rrëshqitja të mbahet në monitorim nga personat përgjegjës të njësive administrative përkatëse. Në studimet e zonave që përfshijnë banesa në trupin e rrëshqitjes, rekomandohet që banorët të largohen nga banesat e tyre.

Janë dërguar rreth 40 shkresa me kërkesë kryerjen e studimit gjeologo-inxhinierik Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për zona në 11 bashki.

Ju është dërguar shkresë disa bashkive, përsa i përket monitorimit, vlerësimit sasior dhe cilësor të ujërave nëntokësore në basenet kryesore ujëmbajtëse.

Ju është bërë shkresë 61 bashkive, për marrjen e masave mbi sigurinë e digave në administrim të bashkive, ku kemi kërkuar marrjen e masave me qëllim shmangien e fatkeqësive që mund të ndodhin nga problematikat në digat e rezervuarëve.

Janë analizuar dhe vlerësuar informacionet periodike në lidhje me problematikat e hasura në rezervuarë të cilët janë në administrim nga bashkitë, ku në shumicën e rasteve kanë pasur problematika përsa i përket ujëlëshuesve, shkarkuesëve katastrofikë, skarpatës së digës, etj.

V. Ngritja Teknike Profesionale, pjesëmarrje në trajnime:

Personeli i Drejtorisë gjatë vitit 2021 i ka kushtuar një vëmendje të veçantë edhe përfshirjes së tij në trajnime të ndryshme.

Nga punonjësit e kësaj Drejtorie janë ndjekur aktivitetet si më poshtë vijon:

Pjesëmarrje online në Konferencën e parë dhe të dytë planizuese “Respon SEE TTX dhe CPX”, të organizuar nga shteti i Styrias, Austri, në bashkëpunim me EUCP, në datat 7 Prill 2021 dhe 27-28 Tetor 2021.

Pjesëmarrje on-line në Stërviçet “Response SEE TTX” dhe “Response SEE CPX”, të organizuar nga një konsorcium në shtetin e Styrias, Austri, në bashkëpunim me EUCP në datën 1 dhjetor, 2021.

Qëllimi i kësaj stërviçe ishte forcimi i gatishmërisë nga fatkeqësitë në Ballkanin Perëndimor për të sjellë Shqipërinë dhe Bosnjë-Hercegovinën afër Mekanizimit të Mbrojtjes Civile Evropiane duke rritur ndërveprimin, si dhe bashkëpunimi midis vendeve dhe ERCC-së. Skenari i ushtrimit është simulimi i një tërmeti në rajonin e Sarajevës dhe më pas një tërmeti tjetër në Shqipëri me efekte zinxhir, duke përfshirë gjithë ciklin e një misioni me një fokus të veçantë në Udhëzuesin e HNS dhe çështje që lidhen me Njerëzit me Nevoja të veçanta (PWSN) si dhe në koordinimin civil ushtarak (CMCoord).

Është ndjekur trajnimi online me temë “Së bashku drejt qëndrueshmërisë së qytetit, MCR2030 në Evropë dhe në Azinë Qendore” në datë 06.05.2021.

Pjesëmarrje në Workshop online më 27.05.2021, takimi i parë i organizuar nga Kryqi i Kuq Hungarez nëpërmjet projektit “INDIMA”, me temë “Koordinimi”.

Pjesëmarrje në Workshop online më 17.06.2021, takimi i dytë i organizuar nga Kryqi i Kuq Hungarez, nëpërmjet projektit “INDIMA”, me temë “Mbrojtja Civile dhe Ndihmat Humanitare”.

Pjesëmarrje në Bullgari-Japoni-Ballkani Perëndimor Workshop mbi sfidat e riskut sizmik, Veliko Tarnovo, Bullgari, datë 08-11.11.2021

Pjesëmarrje në takimin online të zhvilluar në kuadër të projektit “Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet menaxhimit ndërkufitar të rrezikut nga përmbytjet në Ballkanin Perëndimor” gffhghgjfjfhj8

Gjithashtu, janë ndjekur shumë trajnime online të organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

**DREJTORI I DREJTORISË SË GATISHMËRISË DHE
KOORDINIMIT TË PËRGJIGJES EMERGJENTE**

Robert Hysenllati



Konceptoi: S. Balliu

D. Dodaj

IK/datë: 05.01.2022